



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 150 Prot.

Tiranë, më 05.03.2021

**UDHËZIM**

Nr. 1, datë 05.03.2021

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 25.02.2020, “PËR  
PROCEDURËN E TRAJNIMIT, TESTIMIT FILLESTAR DHE PERIODIK, SI DHE  
KRITERET PÛRKATËSE TË VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE SHTETËRORË  
DHE VENDORË”**

Në mbështetje të pikës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të germës ë, f, g, të pikës 2, të nenit 16 dhe pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, Inspektori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë,

**UDHËZON:**

1. Në pikën 5, të Kreut I, fjalia e dytë riformulohet me këtë përmbajtje: “Në përfundim të trajnimit fillestar bëhet testimi me shkrim dhe me gojë, ndërsa në përfundim të trajnimit periodik bëhet vetëm testimi me shkrim, mbi njohuritë e përfituara gjatë trajnimit.”.
2. Pika 6, e Kreut I, riformulohet me këtë përmbajtje: “Testimi profesional fillestar dhe ai periodik, organizohet nga Inspektorati Qendror.”.
3. Pika 11, e Kreut I, riformulohet me këtë përmbajtje: “Moskalimi i testimit fillestar deri në përfundim të kohës së provës, për shkaqe që varen nga vetë inspektori, shkakton

moskonfirmimin në fund të kohës së provës. Brenda 3 muajve nga moskalimi i testimi fillestar inspektori ri-trajtohet dhe testohet përsëri. Nëse inspektori nuk e kalon edhe testimin e dytë, nuk konfirmohet në detyrë. Vendimi për largimin nga detyra, merret sipas procedurave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.”.

4. Pika 6, e kreut II, riformulohet me këtë përmbajtje: “Trajnimi periodik organizohet sipas programit dhe afatit të miratuar, nga Inspektori i Përgjithshëm. Trajnimi fillestar, për inspektorët në kohë prove, përcaktohet nga Inspektori i Përgjithshëm, në bazë të kërkesave të inspektorateve.”.
5. Në pikën 8 dhe 9, të kreut II, fjala “skualifikim” zëvendësohet me fjalën “përgjashtim”.
6. Pika 2, e Kreut II, riformulohet me këtë përmbajtje: “Inspektori i Përgjithshëm, përcakton datën e testimi fillestar. Inspektorati Qendror njofton njësitë e burimeve njerëzore përkatëse, të paktën 1 (një) muaj përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e testimi.”.
7. Në pikën 4, të kreut III, fjalët “dhe sekretari” hiqen.
8. Pika 6, e Kreut III, riformulohet me këtë përmbajtje: “Sistemi i vlerësimit bazohet në testimin me shkrim dhe me gojë, me 100 pikë, nga të cilat 75 pikë për testimin me shkrim dhe 25 pikë me gojë.
9. Pika 7, e Kreut III, riformulohet me këtë përmbajtje: “KVFP-ja përgatit pyetjet për testimin me shkrim dhe me gojë, bazuar në fushën e njohurive për të cilat do të zhvillohet testi sipas rregullores për metodologjinë e testimi, të cilat miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.”.
10. Fjalja hyrëse e pikës 8, të Kreut III, riformulohet me këtë përmbajtje: “KVFP-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga realizimi i testimi, nxjerr rezultatet e përgjithshme të testimi me shkrim dhe me gojë. Inspektori i Përgjithshëm, njofton strukturën përgjegjëse të inspektimit, për rezultatin e testimi, sipas kësaj skeme:”.
11. Pika 13, e Kreut III, riformulohet me këtë përmbajtje: “Programi i trajnimit, për inspektorin e përcaktuar në pikën 11, të këtij kreu, hartohet nga Inspektorati Qendror, bazuar në raportin e KVFP-së, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të inspektimit dhe miratohet nga Inspektori i Përgjithshëm.
12. Pika 14, e Kreut III, riformulohet me këtë përmbajtje: “Inspektori që është vlerësuar “jokënaqshëm”, edhe pas testimi të dytë, konsiderohet jo i përshtatshëm për pozicionin e punës ku është caktuar dhe shkakton moskonfirmimin, si dhe ndërprejën e marrëdhënieve të punës.”.
13. Në pikën 2, të Kreut IV, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “dhe kryhet vetëm me shkrim.”.

14. Në pikën 4, të Kreut IV, fjalët “Inspektorati Qendror” zëvendësohet me “Inspektori Përgjithshëm”.
15. Në pikën 6, të Kreut IV, fjalët “për inspektimin”, hiqen.
16. Pika 7, e Kreut IV, riformulohet me këtë përmbajtje: “Inspektorati Qendror, bazuar në informacionin e dorëzuar nga struktura përgjegjëse e inspektimit, është përgjegjës për njoftimin e kryerjes së testimit periodik.”.
17. Pika 5, e Kreut 5, riformulohet me këtë përmbajtje: “Inspektorati Qendror në bashkëpunim me njësitë e burimeve njerëzore të strukturave përgjegjëse të inspektimit, përcakton kalendarin e zhvillimit të testimit, fushat e legjislacionit të cilat kanë pësuar ndryshime, si dhe të gjitha ndryshimet përkatëse, dhe miratohen brenda muajit Shkurt të çdo viti, nga Inspektori i Përgjithshëm. Pranimi i inspektorëve në testim, bëhet vetëm pas konfirmimit nga Inspektori i Përgjithshëm.”.
18. Në pikat 6, 7, 8, 9 dhe 18, të Kreut V, si dhe pikën 4, të Kreut VI, fjalët “Inspektorati Qendror” zëvendësohen me fjalët “Inspektori i Përgjithshëm”.
19. Në pikën 9, të Kreut V, fjalët “me shkrim” hiqen.

Ky udhëzim publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al), si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore, Vendore dhe strukturave përgjegjëse sipas fushave të inspektimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**  
**SHKËLQIM HAJDARI**

